

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 459
prot

Kucove me 06/07 / 2024

VENDIM

Nr. 4 datë 30.01.2024

Mbi Miratimin e Kritereve te Dhenies se Ndhimes Ekonomike nga Fond i Kushtezuar per Bllok-Ndihmen Ekonomike deri ne 6% dhe/ose me Fonde te Buxhetit Vendor.

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015“Përvetëqeverisjen vendore”, nenit 21 të ligjit nr.9355 dt.10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, ne piken 13 Kreu II, te VKM nr.955 dt.7.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” te ndryshuar, Udhëzimit nr.5 dt.17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind” i ndryshuar të Ministrisë së Mireqënies Sociale e Rinisë, me propozim te Drejtorise e Shërbimit Social, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1.Te miratoje kriteret per dhenien e ndihmes ekonomike nga fondi shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike I cili eshte 6% e ketij fondi dhe mbi ketefond mund te shtohen ose jo edhe fonde te buxhetit vendor.

2.Kriteret sipas pikes numer 1 te ketij project-vendimi jane si me poshte :

- Familje te varfra te cilat nuk jane shpallur perfituese nga sistemi I pikezimit.
- Familje me kryefamiljare gra qe jane te ve ,te divorcuara,vajze nene ne veshtiresi ekonomike dhe sociale.
- Persona te paafte ,te vetmuar te cilet nuk kane asnje burim te ardhurash.
- Familje me femije ne risk,referuar nga Njesia e Mbrojtjes se Femijve .
- Persona te cilet jane te dhunuar ne familje ,trafikimit apo perdorues te substancave psiko-aktive.
- Familje qe kane ne perberje anetare mbi moshe pune.



3. Dokumentat e aplikuesve te jene sipas VKMnr 597,date 04.09.2019 “Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmes eko nomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike”

4. Masae Ndhimes Ekonomike te perllogaritet sipas VKM nr.597,date 04.09.2019”Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike “

5. Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi drejtoria e Sherbomit Social.

6. Ky vendim u miratua 23 vota pro, - vota kunder , - vota abstenim, ne presence te 23 anetareve te Keshillit Bashkiak.

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK

Aleksander ZIU

